REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
AUTORITETI KOMBËTAR I KUALIFIKIMEVE
NACIONALNI AUTORITET ZA KVALIFIKACIJE
NATIONAL QUALIFICATION AUTHORITY
Nr. Prot: 04/12 Data: 06.09.2012
Br. Prot: Datum:
Prot. No.: Date:
PRISHTINË/PRIŠTINA/PRISTINA

Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 04/12
Datë 06.09.2012

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare të datës 7 nëntor 2008 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 1/2011- Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 4,7,10 dhe 16, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 04.09.2012 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Për akreditimin e Qendrës Rajonale për Aftësim Profesional, Ferizaj, për periudhën 3 vjeçare: 01/09/2012 - 01/09/2015 për këtë/o kualifikime të aprovuara:

1.1. Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit; niveli i KKK-së: (III)

Validimi i kualifikimit dhe akreditimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

Kushtet:

- Të vazhdohet në përfundimin e procedurave të sistemit për sigurimin e cilësisë, përfshirë edhe dokumentacionin dhe mekanizmat përkatës. (01. 09. 2013)
- Dëshmitë mbi analizën e tregut për profilin e ujësjellësit dhe kanalizimit për të percjellur risitë në këtë fushë dhe kërkesat e tregut. (Në vazhdimësi).
- Zbatimi i plotë i procedurave të sigurisë. (01.10. 2012)
- Të vazhdohet në përfundimin e procedurave të sistemit për sigurimin e cilësisë, përfshirë edhe dokumentacionin dhe mekanizmat përkatës; zhvillimi i manualit të cilësisë, hartimi i planeve vjetore për monitorim, verifikim dhe vlerësim të brendshëm, instrumenteve për monitorim të procesit të trajnimit, procesverbalet e

takimeve të brendshme, të hartohet lista për hyrje dhe daljen e materialit në depo/ dhe ose shpenzimet nga kandidatët. (Në vazhdimësi)

- Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i trajnerëve (trajnime të vazhdueshme për metodologjinë e mësimdhënies, vlerësimit dhe zhvillimin e instrumenteve të vlerësimit). (01.10 2012)

1.2 Instalues Elektrik; niveli i KKK-së: (III)

Validimi i kualifikimit dhe akreditimi i institucioni/ofruesit për këtë kualifikim nuk është aprovuar deri sa të plotësohen kushtet si në vijim me afat deri me 04.03.2013:

Kushtet:

- Vijueshmëria e kandidatëve të regjistrohet sikurse është duke u bërë edhe tani, por kandidati të nënshkruhen vetë në listë. (04.03.2013)
- Lista e pajisjeve totale në kabinetin për elektroinstalues është e disponueshme vetëm nga ana e trajnerit. Të krijohen lista të ndara të cilat tregojnë për përmbajtjen e materialeve dhe veglave që gjenden në secilin dollap apo panel. Lista duhet të jetë e dukshme gjatë gjithë kohës. (04.03.2013)
- Bazuar në standardet për sigurinë e kandidatëve të cilët punojnë me panele del se panelet nuk janë të sigurta sepse çelësat diferencial janë 0.3A dhe 0.5A. Rekomandohet që këta çelësa të ndërrohen dhe të jenë 0.03A. (04.03.2013)
- Në kabinet janë të montuara panelet e vjetra, kurse panelet e reja të cilat janë marrë si donacion nuk janë montuar si pasojë e mungesës së udhëzuesve për instalim. Rekomandohet që të sigurohen udhëzimet dhe të instalohen panelet e reja. (04.03.2013)

2. Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit, me datë: 04.09.2012, Këshilli Drejtues i AKK-së merr këtë vendim bazuar në rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara dhe këto rekomandime janë të mbështetura në fakte dhe dokumente si në vijim:
-Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit;
-Aplikacioni për Akreditim si Institucionit Ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit;
-Raporti i Vetë-vlerësimit;
-Vizita në institucionin/ofruesin aplikues, dhe
- Dokumente tjera shtesë.

2.1. Pala e pakënaqur me vendimin, ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

3. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim për kualifikimin Instalues Elektrik duhet të përmbushen në afatin e caktuar nga AKK deri më 04.03.2013.
AKK mbledh panelin vlerësues të përbërë nga eksperti i fushës përkatëse, për verifikimin e kushteve të caktuara nga ky vendim.

3.1 Në bazë të rezultateve dhe rekomandimeve të dala nga vizita, KD i AKK-së do të merr vendimin për aprovim/akreditim ose mos aprovim/akreditim.

3.2 Institucioni QRAP Ferizaj obligohet që të marr mbi vete shpenzimet për ekspert (një ditë pune sipas UA. nr.1/2011), Institucioni është i liruar nga pagesat tjera administrative.

4. Kushtet tjera të parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen në afatin e caktuar nga AKK, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimin dhe akreditimit.

5. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

6. Vendimi u dërgohet:

- "QRAP" Ferizaj;
- AKK-së.

Kryetari i KD së AKK-së
Ragip Gjoshi